



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

ALBANIA

Per shperndarje te menjehershme:

23 Shkurt 2010

Per me shume informacion:

Kontakttoni: Zj.Silvana Meko

Zyre: +355-4-266-637

Cel: 0694033831

Email: smeko@lgpa.al

<http://albania.usaid.gov>

www.lgpa.al

PRESS RELEASE

Sistemi i ri i taksave në Fier përmirëson shërbimet publike

FIER, 23 SHKURT 2010 Kryetari i Bashkisë së Fierit, Zoti. Baftjar Zaqaq, dhe Oficeri i USAID, Stephen Herbaly, përruan sot një sistem të ri të kompjuterizuar të taksave vendore. Sistemi i programit u zhvillua nëpërmjet Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA). Sistemi i ri i taksave mundëson një administrim më të efektshëm dhe më efikas të vjeljes së taksave dhe ofrimit të shërbimeve që do të rezultojnë në të ardhura më të mëdha nga taksat për bashkinë dhe në shërbime më të mira për qytetarët e Fierit.

Departamenti i taksave në Bashkinë e Fierit i kryente funksionet në mënyrë manuale. Me sistemin e ri të kompjuterizuar, departamenti i taksave do të ulë kohën që duhet për të llogaritur saktësisht detyrimet tatimore, për të evidentuar pagesat e taksave, do të hartojnë raporte më të mira dhe më të shpeshta si dhe do të analizojnë të ardhurat nga taksat, të rëndësishme për zyrtarët e urbanistikës dhe të tjerë. Me kompjuterizimin e sistemit të taksave Bashkia e Fierit do të përmirësojë dhe do të jetë në gjendje të vjelë më shumë të ardhura nga taksat dhe të ofrojë shërbime bashkiake më të sakta për qytetarët e saj. Gjithashtu, ajo do të pakësojë ndërveprimet personale me punonjësit e tatimeve që shpesh konsiderohen si burim i praktikave korruptive.

Mbështetja e USAID-it për kompjuterizimin e drejtorisë të taksave në bashkinë Fier arrin vlerën mbi 4 milion Lekë.

Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) punon me bashkitë partnere në Shqipëri për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë vendore, për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe për fuqizimin e pjesëmarrjes dhe angazhimit të së shoqërisë civile dhe të sektorit privat në zhvillimin vendor. Përveç Fierit, Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri asiston në Elbasan, Fier, Fushë-Krujë, Gramsh, Korçë, Kukës, Librazhd, Pogradec dhe Shkodër.

###